

**MAREVESHJE
MIDIS
QEVERISE SHQIPETARE
DHE
QEVERISE MAQEDONE**

**NE LIDHJE ME
NDIHMEN E NDERSJELLTE DHE BASHKEPUNIMIN MIDIS
ADINISTRATAVE TE TYRE DOGANORE**

Qeveria Shqiptare dhe Qeveria e Maqedone, qe ketu e tutje te referuara si "Palet Kontratuese",

Duke mbajtur parasysh se shkeljet e legjislacionit doganor jane me pasoja per interesat ekonomike, fiskale, shoqerore, dhe tregtare te vendeve respektive;

Duke mbajtur parasysh rëndesine e sigurimit te vjeljes se sakte te detyrimeve Doganore dhe taksave te tjera per importimin dhe eksportimin e mallrave si dhe njekohesisht percaktimin e sakte te vleres dhe origjines se mallrave;

Duke pranuar nevojën e bashkepunimit nderkombetar ne çeshtjet qe lidhen me aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit Doganor;

Te bindur se veprimet kunder shkeljeve doganore mund te behen me efektive permes bashkepunimit ndermjet Autoriteteve te tyre Doganore;

Duke mbajtur parasysh lehtesimin e kalimit te pasagjereve dhe mallrave;

Ne perputhje me Rekomandimet e Keshillit te Bashkepunimit Doganor per Ndihmen e Ndersjellte Administrative te 5 Dhjetorit, 1953;

rene dakort si me poshte;

Neni 1

Perkufizime

Per qellime te kesaj Marreveshje:

1. Termi "**Legjislacion Doganor**" do te kuptohet si teresi e ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi apo te administruara nga Autoritet Doganore, ne lidhje me importimin, eksportimin apo tranzitin e mallrave nderkohe qe ato i nenshtrohen detyrimeve doganore, perfshire edhe masat kufizuese, ndalimin dhe kontrollin per levizjen e mallrave pertej kufijve kombetar;
2. Termi "**Shkelje Doganore**" do te kuptohet si çdo shkelje apo tentative shkeljeje te Legjislacionit Doganor;



3. Termi “**Detyrime Doganore**” do te thote te gjitha detyrimet, taksat, tatimet dhe ose shpenzimet e tjera qe paguhen dhe mblidhen ne territoret e Paleve Kontratuese ne zbatimin e legjislacionit doganor, ne lidhje me importimin apo eksportimin e mallrave, por nuk perfshin tatimet dhe shpenzimet e tjera te cilat jane te kushtezuara ne sasi per koston e perafert te sherbimeve te ofruara;
4. Termi “**Autoritete Doganore**” do te kuptoje Administraten Doganore Shqiptare dhe Administraten Doganore Maqedone.

Neni 2

Fusha e Marreveshjes

1. Gjithe ndihma sipas kesaj Marreveshje, nga secila Pale Kontratuese, do te kryhet ne perputhje me legjislacionin e brendshem te Pales Kontratuese kerkuese.
2. Administratat Doganore te Paleve Kontratuese do te kooperojne dhe ndihmojne njera tjetren, ne drejtim te sigurimit te zbatimit te sakte te legjislacionit Doganor, dhe per ndalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje.

Neni 3

Fusha e Ndhimes

1. Administratat Doganore i japin njera tjetres, qofte me kerkese apo me iniciativen e tyre, te gjithe informacionin e nevojshem qe mund te ndihmoje ne sigurimin e zbatimit te sakte te legjislacionit Doganor duke perfshire, inter alia, informacion per:
 - (a) te siguruar percaktimin e sakte te detyrimeve dhe taksave te importit dhe eksportit;
 - (b) te ndihmuar ne percaktimin e sakte te vleres se mallrave per qellimet Doganore;
 - (c) te ndihmuar ne percaktimin e klasifikimit tarifor dhe origjines se mallrave.
2. Ndhima e parashikuar ne kete Marreveshje, do te perfshije, por nuk do te kushtezohet vetem ne:
 - (a) kryerjen e veprimeve qe mund te jene te dobishme per paraudatimin e shkeljeve dhe, ne vecanti, menytrat e vecanta te luftes ndaj ketyre shkeljeve;
 - (b) menyra apo metoda te reja te perdorura ne kryerjen e shkeljeve;
 - (c) vezhgime dhe gjetje qe kane rezultuar nga zbatimi i suksesshem i mjeteve dhe teknikave te reja per zbatimin e legjislacionit doganor; dhe
 - (d) teknika dhe metoda te permiresuara per kalimin e pasagjereve dhe ngarkesave.



3. Administratat Doganore te Paleve Kontratuese, ne qofte se nuk bien ne kundershtim me ligjet kombetare, do te synojne gjithashtu bashkepunimin ne:
 - (a) inicimin, zhvillimin, ose permiresimin e programeve te vecanta te trajnimit per personelin e tyre;
 - (b) ngritjen dhe mbajtjen e kanaleve te komunikimit me njeri tjetrit, ne menyre qe te lehtesojne sigurimin e nje shkembimi te shpejte te informacionit;
 - (c) lehtesimin e koordinimit efikas ndermjet neri tjetrit, duke perfshire shkembimin e personelit dhe te eksperteve si dhe punonjesve nderlidhes;
 - (d) marrjen ne konsiderate dhe perdorimin e pajisjeve dhe procedurave te reja;
 - (e) thjeshtezimin dhe harmonizimin e procedurave perkatese doganore; dhe
 - (f) cdo ceshtjeje tjeter administrative qe mund te kerkoje here pas here veprime te perbashketa.
4. Cdo kerkese per arrestim personi do te perjashtohet nga nje ndihme e tille. Gjithashtu, mbledhja dhe perdorimi i forces per mbledhjen e detyrimeve doganore, taksave te tjera, gjobave dhe detyrimeve te ndryshme do te perjashtohet nga kjo ndihme.

Neni 4

Ndihma ne Kontroll

1. Me kerkesen e Administrates qe aplikon, Administrata te ciles i behet kerkesa do te komunikojte informacionin ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:
 - (a) vertetesine e dokumentave zyrtare te nxjerra ne mbeshtetje te deklarates se mallrave qe i paraqitet Autoriteteve Doganore te Pales Kontratuese qe ka bere kerkesen;
 - (b) nese mallrat e importuara ne territorin doganor te Pales Kontratuese qe ka bere kerkesen kane qene ose jo te eksportuara sipas rregullave ligjore nga territori doganor i Pales tjeter Kontratuese;
 - (c) nese mallrat e eksportuara nga territori doganor i Pales Kontratuese qe ben kerkesen kane qene ose jo te importuara ligjerisht ne territorin doganor te Pales Kontratuese te ciles i behet kerkesa;
 - (d) informacion ne lidhje me transportimin dhe levizjen e mallrave, disponimin dhe destinacionin e ketyre mallrave, si dhe vleren dhe origjinen e tyre;
 - (e) katalogun dhe listen e qmimeve te mallrave ne fjale, ne qofte se eshte e mundur.
2. Nje informacion i tille, kur eshte rasti, do te specifikoje edhe proceduren doganore te zbatuar mbi mallrat.

Neni 5

Palet Kontratuese, brenda kopetencave te tyre do ti japin ndihme njera tjetres ne qofte se e konsiderojne te nevojshme per zbatimin korrekt te legjislacionit doganor dhe, ne veçanti, kur ato marrin informacion qe ka lidhje me:

- veprime te cilat kane shkelur, shkelin ose mund te shkelin ligjet ne fuqi dhe qe mund te jene me interes per Palen tjetere Kontratuese;
- mallra te cilat dihen se jane objekt i shkeljeve themelore te legjislacionit doganor ne territorin e Pales tjetere Kontratuese;
- persona, apo firma te veçanta qe dihet se kane kryer, apo dyshohet qe mund te kryejne shkelje te legjislacionit ne fuqi ne territorin e Pales tjetere Kontratuese;
- mjetet e transportit dhe kontenjeret, per te cilet ka njohuri ose egziston dyshimi qe kane qene, jane, ose mund te perdoren ne kryerjen e shkeljeve te legjislacionit doganor ne fuqi te Pales tjetere Kontratuese.

Neni 6

Komunikimi i Kerkesave

1. Forma dhe permbajtja e kerkeses per ndihme:

- (a) Kerkesat, ne perputhje te kesaj Marreveshje, duhet te behen me shkrim. Dokumentat e nevojshme per egzekutimin e kerkesave te tilla duhet te shoqerohen keto kerkesa. Per shkak te nje situate urgjente, mund te behet edhe pranimi i nje kerkeses gojore, por kjo duhet konfirmuar me shkrim sa me shpejt qe te jete e mundur.
- (b) Kerkesat duhet te behen ne anglisht. Çdo dokument qe shoqeron kerkesat duhet, kur eshte e nevojshme, te perkthehet ne anglisht.

2. Kerkesat ne zbatim te paragrafit 1 te ketij Neni duhet te perfshijne informacionin e meposhtem:

- (a) administratan qe ben kerkesen;
- (b) masen qe kerkohet;
- (c) objektin dhe shkakun per te cilen behet kerkesa;
- (d) emrat dhe adresat e paleve me cilat ka lidhje kerkesa;
- (e) nje pershkrim i shkurter i çeshtjes ne fjale dhe elementet juridike qe perfshihen ne te;
- (f) lidhjen ndermjet ndihmes qe kerkohet dhe çeshtjes me te cilen ajo lidhet.

3. Kanalete e Komunikimit:

- (a) Ndhma do te realizohet me komunikim direkt ndermjet Autoriteteve Doganore.
- (b) Ne rastet kur Administrata Doganore e Pales Kontratuese se kerkuar, te ciles i behet kerkesa, nuk eshte institucioni i pershtatshem per te permbushur kerkesen, ajo, pas konsultimeve perkatese, duhet te beje ose transmetimin direkt te kerkeses ne institucionin perkatese, i cili do te veproje


4

per permbushjen e kerkeses ne zbatim te kopetencave qe i njeh ligji, ose te keshilloje Administraten qe ben kerkese qe te ndjeke proceduren e pershtatshme per kerkesen ne fjale.

Neni 7

Egzekutimi i Kerkeses

1. Administrata te ciles i eshte bere kerkesa do te marre, brenda kopetencave te legjislacionit te brendshem, te gjitha masat per egzekutimin e kerkeses brenda nje afati kohor te arsyeshem.
2. Administratat Doganore te seciles Pale Kontratuese, ne baze te kerkeses se Administrates Doganore te Pales tjeter Kontratuese, duhet te kryeje çdo hetim apo vezhgim te nevojshem, duke perfshire, kur eshte e nevojshme, edhe pyetjen e eksperteve dhe deshmitareve apo te personave te cilet dysohen te kene kryer nje shkelje.

Neni 8

Forma ne te cilen duhet bere komunikimi i informacionit

1. Administrata te ciles i behet kerkesa duhet t'ia komunikojë rezultatin e kerkimeve Administrates qe ben kerkesen ne formen e dokumentit, kopjeve te çertifikuara te dokumentave, raporteve, ose te tjera te ngjashme me keto, dhe, kur eshte e domosdoshme, ne menyre gojore.
2. Dokumentat e parashikuar ne paragrafin 1 mund te zevendesohen me informacionin e kompjuterizuar, te realizuar ne çdo lloj menyre, dhe qe permbush te njejtin qellim. Çdo informacion i nevojshem per interpretimin apo nxjerrjen e nje informacioni, te tille duhet te shoqeroje informacionin ne fjale.

Neni 9

Perjashtimet nga Ndhima

1. Ne rastet kur Pala Kontratuese, te ciles i behet kerkesa, gjykon se permbushja e kerkeses mund te demtojë sovranitetin, sigurimin, politiken shoqerore, ose interesa te tjere thelbesore kombetare, ose mund te shkele nje sekret industrial, tregetar apo profesional, mund te refuzoje ndihmen ose mund ta jape ate te kufizuar, per shkak te kushteve dhe kerkeseve perkatese.
2. Kur ndihma refuzohet ose shtyhet, duhet te informohet per keto vendimin dhe per arsyt Administrata kerkuese, sa me shpejt qe te jete e mundur.
3. Ndhima mund te shtyhet nga Administrata, te ciles i behet kerkesa, mbi bazen e ndermarrjes se nje hetimi, ndjekjeje apo procedure qe eshte ne vazhdim. Ne raste te tilla, pala kerkuese do te konsultohet me Palen tjeter Kontratuese kerkuese per te percaktuar nese ndihma mund te jepet ne afatet dhe kushtet e kerkuara.



4. Ne rastet kur Administrata qe ben kerkesen kerkon nje ndihme qe vete eshte e pamundur per ta dhene ne formen qe kerkohet, kete fakt duhet ta beje te njohur ne kerkesen e mesiperme. Pas kesaj, do te jete per Administratan te cilit i behet kerkesa te vendose se si te pergjigjet per nje kerkese te tille.

Neni 10

Perdorimi i informacionit

1. Informacioni, dokumentat, dhe informacionet e tjera te marra ne vazhden e ndihmes se ndersjellte mund te perdoren vetem per qellimet e dhena ne kete Marreveshje, duke perfshire perdorimin e tyre ne hetime, procedurat juridike dhe administrative.
2. Administrata qe ben kerkesen nuk duhet te perdore evidencen ose informacionin e marre ne zbatim te kesaj Marreveshje per qellime te tjera te ndryshme nga ato te parashtruara ne kerkesen e bere, pa pelqimin me shkrim te Administratat te ciles i behet kerkesa.
3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 te ketij Neni nuk perfshijne informacionin qe lidhet me shkeljet qe kane te bejne me drogat narkotike dhe substancat psikotrope dhe prekursoret. Nje informacion i tille mund t'iu komunikohet autoriteteve te Pales Kontratuese, qe ben kerkesen, dhe qe perfshihen direkt ne luften kunder trafikut ilegal te droges.

Neni 11

Fshehtesia e Informacionit

Per çdo informacion, dokumenta, apo komunikime te tjera te dhena ose te marra ne zbatim te kesaj Marreveshje do te trajtohet si te fshehte dhe mund te perdoret vetem per qellimet e parashikuara ne kete Marreveshje. Ato do te mbulohen nga detyrimi i sekretit profesional dhe do te gezojne te njejten mbrojtje, te njohur nen ligjet perkatese qe lidhen me informacione te te njejtës natyre, dokumenta ose komunikimeve te tilla te praktikueshme nga Pala Kontratuese e cila e merr ate informacion.

Neni 12

Dosjet, Dokumentat, dhe Deshmitaret

1. Autoritetet Doganore te Paleve Kontratuese duhet, mbi kerkesen e bere, te japin dokumentacionin qe ka lidhje me transportimin dhe levizjen e mallrave dhe qe pëmban vleren, origjinen, natyren dhe destinacionin e ketyre mallrave.
2. Origjinalet e dosjeve, dokumentave, dhe materialeve te tjera, do te kerkohen vetem ne rastet kur kopjet nuk jane te mjaftueshme. Mbi nje kerkese te veçante, kopjet e dosjeve, dokumentave dhe materialeve te tjera duhet te vertetohen ne menyre te pershtatshme.



3. Origjinalet e dosjeve, dokumentave, dhe materialeve te tjera qe jepen per marrjen e vendimeve gjyqesore, apo per qellime te tjera te ngjashme, duhet te kthehen pa vonese ne baze te nje kerkese.
4. Me kerkesen e Administrates Doganore te njerës Pale Kontratuese, Administrata Doganore e Pales tjetër Kontratuese, kur e gjykon te tille, duhet te autorizojë punonjesit e saj, dhe nese ata nuk e kundërshtojnë një gjë te tille, per tu paraqitur si dëshmitare ne procedurat administrative apo juridike ne territorin e Pales tjetër Kontratuese, dhe te japë dosje, dokumenta dhe materiale te tjera, apo kopjet autentike te tyre, ne qofte se keto konsiderohen themelore per procedurat. Nje kerkese e tille duhet te japë kohen, vendin, dhe llojin e procedurave dhe kapacitetin me te cilin punonjesit duhet te dëshmojnë.

Neni 13

Shpenzimet

1. Autoritetet Doganore te Paleve Kontratuese normalisht duhet te mos njohin asnjë kerkese per rimbursim te shpenzimeve te shfaqura nga egzekutimi i Marreveshjes ne fjale, me perjashtim te shpenzimeve per dëshmitaret, pagesat e eksperteve, dhe shpenzimet per perkthyesit qe nuk jane punonjes zyrtare.
2. Kur shpenzime te nje natyre themelore dhe te jashtezakonshme jane ose do te kerkohen per zbatimin e kerkeses, Administratat Doganore te Paleve Kontratuese duhet te konsultohen per te vendosur per afatet dhe kushtet ne baze te te cilave do te zbatohet kjo kerkese, si dhe ne te njejtën kohe menyren e ndarjes se shpenzimeve.

Neni 14

Zbatimi dhe Mosmarreveshjet

1. Zbatimi i kesaj Marreveshje i eshte besuar Administratave Doganore te Paleve Kontratuese. Ato vendosin per marrjen e te gjitha masave dhe gjetjen e menyrave te nevojshme per zbatimin e saj, duke patur parasysh udhezimet fushen e mbrojtjes se te dhenave.
2. Pas konsultimeve, Administratat Doganore te Paleve Kontratuese mund te nxjerrin udhezime administrative te nevojshme per zbatimin e kesaj Marreveshje.
3. Administratat Doganore te Paleve Kontratuese duhet te percaktojnë zyrtaret pergjegjes per komunikimin e ndersjellte dhe, per kete qellim, duhet te shikembajne një liste me emrat, titujt, numrin e telefonit dhe faksin te ketyre personave. Ato mund te marrin gjithashtu masa qe sherbimet hetimore te tyre te jene ne lidhje direkte me njeri-tjetrin.
4. Mosmarreveshjet dhe konfliktet per te cilat nuk eshte gjetur asnjë zgjidhje duhet te zgjidhen nepermjet kanaleve diplomatike.

Neni 15

Zbatimi

Kjo Marreveshje do te jete e zbatueshme ne territoret Doganore te te dyja Paleve Kontratuese, sikurse percaktohet ne dispozitat e tyre kombetare ligjore dhe administrative.

Neni 16

Hyrja ne Fuqi dhe Perfundimi

1. Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ditën e marrjes se njoftimit te fundit me shkrim, nepermjet kanaleve diplomatike, qe konfirmon se jane permbushur te gjitha procedurat, konform legjislacionit kombetar, per hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshje.
2. Administratat Doganore te Paleve Kontratuese bien dakort qe me kerkesen e njerës Pale, ose ne fund te pese vjeteve nga data e hyrjes ne fuqi, te takohen per te rishikuar kete Marreveshje, ose te diskutojne çdo lloj çeshtje tjeter doganore qe mund te rezultoje nga marredheniet ndermjet tyre, me perjashtim te rastit kur ato njoftojne njera-tjetren me shkrim qe nuk eshte i nevojshem nje rishikim i tille.
3. Kjo Marreveshje do te qendroje ne fuqi per nje periudhe kohe te papercaktuar. Do te perfundoje brenda tre muajve nga data ne te cilen njera nga Palet Kontratuese ka njoftuar me shkrim, permes kanaleve diplomatike, Palen tjeter qe deshiron ta perfundoje Marreveshjen. Megjithate, procedurat qe kane filluar ne kohen e perfundimit te kesaj Marreveshje do te kryhen plotesisht.

Nenshkuar me _____, me date _____, 1997 ne dy origjinale, ne gjuhet Shqip dhe Maqedonisht, me permbajtje te njejte te teksteve.

PER QEVERINE SHQIPTARE

PER QEVERINE MAQEDONE